



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ARMAKOS" Sh.P.K. të datës 02.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi laurave, pengesave të hyrjes së automjeteve në objektet e Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-1625-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ARMAKOS" Sh.P.K. e datës 02.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi laurave, pengesave të hyrjes së automjeteve në objektet e Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-1625-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "ARMAKOS" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "ARMAKOS" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 02.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi laurave, pengesave të hyrjes së automjeteve në objektet e Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-1625-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Me date 02/06/2023 ne portalin e e-prokurimit është publiku njoftimi mbi vendimin e AK Kuvendi Komunal i Prishtinës për ofertuesin e sukseshem me te cilin njoftohemi se kompania ARMAKOS Shpk pas ankeses se OE Profesional Alarm është diskulifikuar për arsye se gjoja nuk kemi permbushur kerkesat sigurimit i tenderit konkretisht neni 57 pika 4.3... Ne kemi dorezuar tenderin/oferten tone me date 20/05/2023 ku i kemi bashkangjitur edhe sigurimin e tenderit ne vlere 1000 eur siq është kerkuar ne afat prej 90 ditesh. konform nenit 57 te LPPK dhe pikes 4.3. "afati kohor për pranimin e sigurimit të tenderit, që është i njëjtë me atë për pranimin e tenderëve".

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 56, 57 dhe 72 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar provat materiale si në vijim:

- B05 Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit të datës 03.03.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 21.03.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 30.03.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 05.04.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 13.04.2023.
- Oferta e tenderuesit të rekomanduar "Profesional Alarm" Sh.P.K.
- Oferta e parashtruesit "Armakos" Sh.P.K.
- B12 Procesverbali i hapjes së tenderëve i datës 27.04.2023.
- Dokumentet shtojca – kërkesat për sqarim dhe sqarimet e ofruara.
- Raporti i komisionit për vlerësim i datës 19.05.2023.
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontratës i datës 19.05.2023.
- Vendimi i AK në kërkesën për rishqyrtim të dt. 29.05.2023.
- Raporti i komisionit për rivlerësim i datës 01.06.2023.
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontratës i datës 02.06.2023.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 07.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

**Lidhur me pretendimet e parashtruesit – fillimisht duhet cekur se sipas dosjes së tenderit (tutje "DT") nr. i nenit 13.2 është përcaktuar se shuma e sigurimit të tenderit është 1,000.00 Euro ndërsa afati është për 90 ditë. Në anën tjetër përmes formularit B54 Formularit standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të dt. 13.04.2023 është bërë njoftimi se hapja e ofertave do të bëhet me datë 27.04.2023 në ora 13:30. Ky fakt mund të konfirmohet edhe përmes procesverbalit të hapjes së tenderëve të datës 27.04.2023. Pra nuk është aspak kontestuese që kriteri i DT ka qenë sigurimi i tenderit me vlefshmëri prej 90 ditëve konkretisht duke filluar nga data e hapjes së tenderëve me 27.04.2023 deri me datë 25.07.2023.**

Tutje si provë është administruar edhe oferta e parashtruesit ku është gjetur se i njëjti ka dorëzuar edhe sigurinë e tenderit sipas nr. të policës 060010150089211 në shumën 1,000.00 Euro. Mirëpo sigurimi është përcaktuar me vlefshmëri nga vetëm nga data 27.03.2023 deri me datë 25.06.2023. Polica e sigurimit është lëshuar nga K.S. "SIGKOS" Sh.a. me datë 27.03.2023. Kjo nënkupton që vlefshmëria e sigurimit të tenderit në rastin konkret përfundon para datës 25.07.2023 dhe rrjedhimisht nuk është në përputhje me kriterin e DT. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë i parashtruesi është i bazuar pasi që komisioni vlerësues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP lidhur me nenin 28 të RRRP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.06. 2023

  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### **Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.